



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçante



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201500842/4

Tiranë ____/____/2015

Lënda: Rekomandohet *"Marrja e masave me qëllim përmirësimin e punës për zbatimin rigoroz të dispozitave ligjore, në lidhje me trajtimin e të dënuarve me burgim dhe rasteve kur ata paraqiten me çrregullime mendore"*.

Analiza për rastin e të dënuarit A. L., me sëmundjen e epilepsisë, dhe marrja e masave ndaj personave përgjegjës.

Drejtuar : Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve
Z. Artur ZOTO

Për dijeni: Ministrit të Drejtësisë
Z. Nasip NAÇO

TIRANË

I nderuar Z. ZOTO,

Mbi njoftimin e të dënuarit A. L., nga IEVP Durrës, më datën 06.06.2015, Avokati i Popullit ka urdhëruar kryerjen e një hetimi të pavarur administrativ, lidhur me shqetësimin e tij se, policët e grupit të gatshëm I. M., T. B., dhe Armir M., rreth orës 21.00 të datës 05.06.2015, kishin ushtruar dhunë fizike tek dhoma e infirmjerisë.

Gjatë hetimit administrativ janë marrë shpjegime ankuesit A. L., dhe personave që kishin dijeni për ngjarjen si atyre që ndodheshin në dhomë me me të, ashtu dhe punonjësve të personelit mjekrësor e policëve të grupit të gatshëm. Ndihmës Komisionerët e Avokatit të Popullit kanë realizuar foto të dëmtimeve të dukshme në trupin e të dënuarit A. L., kryesisht në kërcinjtë e këmbëve, si dhe janë administruar dokumente të ndryshme si, regjistri i vizitave në infirmjeri e dosja personale.

Mbi kërkesën e Avokatit të Popullit, më datën 08.06.2015, është kryer ekspertimi mjeko ligjor nr.462 i të dëmtuarit Adriatik Lala, në konkluzionet e të

cilit thuhet se: "...Tek i dëmtuari A. L., u konstatuan dy dërmishje e tre gërvishtje në kërcirin e djathtë, dhe një gërvishtje në kërcirin e majtë, enjtje (edemë) dhe skuqje (hiperemi). Dëmtimet e konstatuara janë shkaktuar me mjet të fortë mbrerës".

Në pjesën përshkruese të aktit mjeko ligjor sqarohet se: "...i dënuari A. L., u konsultua për dhimbje të veshit të djathtë me mjeken specialiste otojate Dr.Elona Kodra, e cila konstatoi edemë (enjtje dhe hiperemi) të membramës timpanike (infeksion) dhe prania e theksimit të kockave të membramës himpanike. Nga provat e dëgjimit nuk është i qartë në përgjigje. Veshi i majtë normal".

Në përfundim të hetimit administrativ duke gjetur se ankesa e të dënuarit A. L., ishte e drejtë, më datën 12.06.2015, me shkresën nr.K2/I18-3, i kemi Rekomanduar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës "Fillimin e hetimit të procedimit penal për veprën penale "Kryerja e veprimeve arbitrare" në bashkëpunim, parashikuar nga neni 250 e 25 të Kodit Penal, në ngarkim të punonjësve të policisë së IEVP Durrës, I. M., T. B., dhe A. M".

Veç sa sipër Ndhmës Komisionerët e Avokatit të Popullit, gjatë hetimit të rastit, konstatuan dhe disa shkelje të dispozitave ligjore si, ligjit 8328 datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i ndryshuar, apo dhe Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.303 datë 25.03.2009, e ndryshuar, të cilat konsistojnë:

Së pari: Qyetari A. L., nga Durrësi, me vendimin nr.(11-2013-3259) 299 datë 18.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, është dënuar me 6 vjet burgim për veprat penale "Vrasja" e mbetur në tentativë dhe "Kundërshtim të punonjësit të policisë së rendit publik", parashikuar nga nenet 76 e 22 dhe 236/2 të Kodit Penal.

Në IEVP Durrës i dënuari A. L., ka ardhur me urdhër transferimi të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, pasi ishte duke vuajtur dënimin në IEVP "Zahari" të Krujës. Deri në momentin e ndodhjes së ngjarjes, i dënuari A. L., ka qëndruar në një dhomë paraburgimi me persona të tjerë të paraburgosur si J. S., etj.

Ky veprim bie ndesh me nenin 75/2 të ligjit nr.40/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8328, datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", të ndryshuar i cili bën fjalë për "Pranimin e të paraburgosurve në Institucion", ku thuhet: "Në çdo rast të paraburgosurit mbahen në seksione të veçuara nga seksioni i të dënuarve me burgim".

Së dyti: I dënuar A. L., vuan nga sëmundja e epilepsisë, fakt ky njohur si nga administratya e IEVP ashtu dhe personeli mjekësor, pasqyruar dhe në kartelën mjekësore nr.374 datë 05.06.2012, të Komisarariatit të Policisë Durrës, e cila ndodhet në dosjen personale të të dënuarit, si dhe libri i shkarkimit të medikamenteve të urgjencës në IEVP Durrës.

Në shkencën e mjekësisë, Epilepsia është mbingarkesë e një aktiviteti elektrik dhe një nga sëmundjet më të shpeshta në neurologji. Ajo i takon grupit të sëmundjeve konvulsive e cila manifestohet me ngërçe të muskujve dhe

ndryshim të furishëm të vetëdisjes. Për rrjedhojë, pacienti me sëmundjen e epilepsisë kërkon mbikqyrjen e mjekut i cili duhet të bëjë një mjekim të pandërprerë dhe për një kohë të gjatë. Në përfundim mund të themi se i sëmuri epileptik kërkon mjekim dhe veprim antiepileptik të medikamenteve, por njëkohësisht ndikim me një varg metodash terapeutike për frenimin e sëmundjes.

Është e papranueshme mbajtja në mjedise paraburgimi e të dënuarit Adriatik Lala. Ajo sjell pasoja të dëmshme në shëndetin e tij, shqetësime tek të paraburgosurit e dhomës dhe mjedisi përreth. Ky veprim bie ndesh me nenin 32 pika 1 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, miratuar me VKM nr.303 datë 25.03.2009, ku thuhet: *“Drejtoria e IEVP siguron shërbimin mjekësor pa ndërperje nën kujdesin dhe kontrollin e personelit mjekësor. Brënda IEVP krijohen seksione të specializuara kliniko mjekësore...”*, si dhe nenin 39 të saj i cili bën fjalë për *“Të burgosurit me çrregullime mendore”* ku thuhet: *“Të burgosurit që konstatohet se vuajnë nga çrregullime të rënda mendore dërgohen në afatin më të shkurtër në institucione të përshtatshme psikiatrike për trajtimin e tyre me qëllim garantimin e trajtimit dhe kujdesit mjekësor të specializuar”*.

I përmëndëm këto dispozita ligjore, në konteks me sëmundjen që paraqet i dënuari A. L., pasi në ditën e ngjarjes datë 05.06.2015, ai ka kërkuar disa herë vizitë tek mjeku, dhe në orën 21.00 kur gjëndja shëndetësore është përkeqësuar, ka insistuar tek ndihmës mjekut A. Ç., që të shënojë emrin e tij për vizitë tek mjeku, veprim i cili është realizuar në datën 06.06.2015, duke e çuar për vizitë në Spitalin Rajonal Durrës. Më pas dhe konkretisht më datën 08.06.2015, i dënua A. L., është transportur në Spitalin e Burgut Tiranë ku edhe ndodhet aktualisht nën kujdesin e personelit mjekësor.

Do të sugjeronim që rasti i të dënuarit A. L., për shkeljet e sipërcituara duhet të analizohet dhe në përfundim, të merren masat dispilonore ndaj personave përgjegjës. Nga ana e juaj gjithashtu duhet të bëhet evidentimi i rasteve të tilla të mundshme në të gjitha IEVP-të, duke marrë masat e nevojshme me qëllim mospërsiritjen e tyre në të ardhmen.

Për sa më sipër dhe bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të drejtave të njeriut nga administrate publike”* dhe në bazë të nenit 21 gërma “c” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”* me ndryshimet përkatëse ku thuhet: *“Avokati i Popullit pas përfundimit të hetimit, paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vënd të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen”*,

REKOMANDOJMË

“Marrjen e masave me qëllim përmirësimin e punës, për zbatimin rrigoroz të dispozitave ligjore në lidhje me trajtimin e të dënuarve me burgim dhe rasteve kur ata paraqiten me çrregullime mendore”.

Analizën për rastin e të dënuarit A. L., me sëmundjen e epilepsisë, dhe marrjen e masave ndaj personave përgjegjës.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij Rekomandimi, lutemi na njoftoni brënda afatit ligjor prej 30 ditë, e parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj.

Konc.&Dakt.P.A.
Tiranë më 16.07.2015

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI